

Seminari i Projekt Grupit të EUROSAT-t për Qëllimin Strategjik 1 “Klubi i Ekspertëve” 5 qershor 2024

Auditues të Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit në KLSH morën pjesë online në seminarin e Projekt Grupit të EUROSAT-t për Qëllimin Strategjik 1 (SG1) në kuadër të inisiativës “Klubi i Ekspertëve”, organizuar nga SAI-t e Lituaniës, Maltës dhe Izraelit.



Seminari ishte i organizuar në dy sesione, ku ekspertet ofruan njohuritë e tyre në dy tema, të cilat fokusoheshin në:

- Mundësitë e përdorimit të Inteligjencës Artificiale në auditimin e sektorit publik;
- Praktikën dhe përfitimet në auditimin financiar, të performancës dhe përputhshmërisë të kombinuara së bashku me auditimin e IT.

Institucionet Supreme të Auditimit që prezantuan zhvillimet e tyre, përfitimet, risqet dhe sfidat lidhur me Inteligjencën Artificiale ishin: Malta, Lituania, Izraeli, Estonia, Letonia dhe Gjermania.

Në prezantimet dhe diskutimet e grupit të ekspertëve, u theksua se zhvillimet teknologjike në 5 vitet e ardhshme do të shkurtojnë vende pune të ndryshme, por përballja me këto ndryshime dhe sfidat do të jenë të shumta.

Në përfundim të seminarit u zhvilluan sondazhe online të pjesëmarrësve mbi zhvillimet që kishin në drejtim të auditimit të teknologjisë së informacionit si dhe përdorimin e AI nga institucionet e auditimit që përfaqësonin.

Përgjigjet treguan se ndryshimet ndodhin ngadalë dhe nevoja për përshtatjen me përdorimin e ndryshimeve teknologjike në auditim, do të na shoqërojë në vitet në vijim.